



Save the Children

Programi për Shqipërinë



ZHVILLIMI I FËMIJËRISË SË HERSHME

Udhëzues praktik për etapaf zhvillimore
tek fëmijët e moshës 0-5 vjeç

Zhvillimi i fëmijërisë së hershme kalon në disa etapa themelore, të cilat do të paraqiten në faqet e këtij libërthi. Ju prindër, kujdestarë në çerdhe, mësues në kopshte, jeni ata që u ofroni fëmijëve mbështetje për tu rritur, zhvilluar dhe mësuar.



Ju bëni të mundur që ata të përdorin mundësitë dhe aftësitë e tyre në mënyrën më të plotë të mundshme. Vëzhgoni rritjen e tyre dhe ndihmoni të zhvillohen plotësisht, në të katër drejtimet kryesore:


- **ZHVILLIMIN TRUPOR**
- **ZHVILLIMIN E MENDJES**
- **ZHVILLIMIN E MARRËDHËNIEVE**
- **ZHVILLIMIN E KOMUNIKIMIT**

Materiali i këtij libërthi është nxjerrë dhe përshtatur nga prezantimi i "ECD introduction", i seancës së parë të trainimit nëpërmjet internetit, organizuar nga Save the Children, USA, në 13 tetor 2009.

ZHVILLIMI I TRUPOR

(Fusha e motorikës së madhe dhe të vogël)

Brenda muajit të 4	Brenda moshës 1-vjeçare-12 muajsh	Brenda moshës 2-vjeçare	Brenda moshës 3-vjeçare	Brenda moshës 5-vjeçare
<ul style="list-style-type: none"> • Ngre kokën dhe gjoksin dhe mban trupin me krahët mbështetur në shtrat, kur qëndron shtrirë barkas • Shkelmon si kur qëndron shtrirë barkas ashtu edhe në shpinë • Arrin dhe kap objektet • Shqisat e nuhatjes, shijes, dëgjimit dhe shikimit janë të zhvilluara mirë 	<ul style="list-style-type: none"> • Rrotullohet nga mbarë prapë • Zvarritet përpara me bark • Qëndron ulur pa u mbajtur • I jep trupit për tu çuar në këmbë • Mban shishen • Zhvendos objektet nga një dorë në tjetrën • Përdor gishtërinjtë për të kapur sendet • Përplas objektet me njëri-tjetrin 	<ul style="list-style-type: none"> • Ecën vetë dhe mban objekte të vogla • Nis të vrapojë • Shqelmon topin • Hipën lart dhe zbrit poshtë • Mund t'u heqë kapakun tenxhereve • Ngre kulla • Mund të mbajë një lugë e të hajë vetë • Përplas duart 	<ul style="list-style-type: none"> • Ecën lart e poshtë shkallëve • Vrapon me lehtësi • Përkulet me lehtësi • I kthen faqet e librit një nga një • Shkarravit dhe mban lapsin/stilolapsin • Lan duart dhe dhëmbët 	<ul style="list-style-type: none"> • Qëndron në një këmbë, • Kërcen mbi një këmbë, lëkundet, mund të jetë në gjendje edhe të kërcëjë nga njëra këmbë në tjetrën • Mund të vizatojë dhe të kopjojë forma dhe njerëz të shoqëruar me trupin e njeriut • Vishet e zhvishet pa ndihmë • Zakonisht kujdeset vetë për nevojat personale në tualet



ZHVILLIMI I MENDJES (Fusha njohëse)

Brenda muajit të 4	Brenda moshës 1-vjeçare-12 muajsh	Brenda moshës 2-vjeçare	Brenda moshës 3-vjeçare	Brenda moshës 5-vjeçare
<ul style="list-style-type: none"> • Eksploron objektet duke i futur në gojë • Njeh fytyrat familjare • Dallon ngjyrat nga njëra-tjetra • I sheh objektet me përqendrim • Preferon modele të ndërlkuara pamore dhe zanore 	<ul style="list-style-type: none"> • Eksploron objektet në shumë mënyra të ndryshme - duke i shkundur, përplasur, flakur tutje apo lënë të bien. • Gjen me lehtësi objektet e fshehura • Kupton veprimet e thjeshta shkak-pasojë • Mund të imitojë veprime dhe gjeeste • Sheh nga fotoja e duhur kur dëgjon emrin e imazhit 	<ul style="list-style-type: none"> • Grupon/ndan objektet e ngjashëm me njëri-tjetrin • Fillon t'i bëjë të tjerët t'i besojnë • Mund të tregojë shumë gjëra nisur nga emri përkatës – përfshi këtu pjesët e trupit, kafshë, njerëz. • Mund të zgjidhë probleme të thjeshta duke bërë prova dhe duke gabuar • Njeh 200-300 fjalë • Është i aftë të dëgjojë ngjarje të shkurtra 	<ul style="list-style-type: none"> • Ndan veç lojërat dhe i eksploron • Kupton se një objekt në dorën e tij dhe objekti në foton e librit janë njësoj • I pëlqen lojërat kur i duhet të bën gjoja sikur.... • ndan objektet sipas formës dhe ngjyrës 	<ul style="list-style-type: none"> • Mund të numërojë 10 apo më shumë objekte • Njeh ngjyrat • E kupton më mirë konceptin e kohës. • Ka njohuri për veprimtaritë e jetës së përditëshme në shtëpi – ushqyerje, të punuarit, kopshtaria, përdorimi i parave.



ZHVILLIMI I MARRËDHËNIEVE

(Aftësitë Socio-Emocionale)

Brenda muajit të 4	Brenda moshës 1-vjeçare-12 muajsh	Brenda moshës 2-vjeçare	Brenda moshës 3-vjeçare	Brenda moshës 5-vjeçare
<ul style="list-style-type: none"> • Njeh zërat, aromat dhe prekjet e personave që kujdesen më shpesh për të • Preferon rrahjet e qeta të zemrës dhe zë femëror mundësisht atë të nënës • Nis të të kthejë buzëqeshjet • Qetëson veten kur është i mërzhitur (duke thithur gishtat etj.) 	<ul style="list-style-type: none"> • I pëlqejnë lojërat sociale • Krijon lidhje të fortë me kujdestarin kryesor • Mund të shfaqë frikë nga të huajt • Shfaq preferenca specifike për njerëzit dhe lodrat • Teston reagimet e prindërve ndaj sjelljes së tij • Mund të dallojë emocionet tek të tjerët (nëse e ëma qan edhe ai mund të qajë pas saj) 	<ul style="list-style-type: none"> • Imiton sjelljen e të rriturve dhe fëmijëve • Është më i ndërgjegjshëm për vetveten si i pavarur nga të tjerët – një veten e tij në pasqyrë/foto • Është entuziast për praninë e fëmijëve të tjerë – mëson të japë e të marrë me ta • Zhvillon më shumë pavarësinë • Luan me lojëra vetëm 	<ul style="list-style-type: none"> • Imiton të rriturit dhe shokët e lojës • Shfaq hapur dashurinë për shokët më të ngushtë të lojës • Mund të mbajë radhën në lojëra • Kupton konceptin “imja”, “e tij/ e saj” • Shpreh një gamë të gjerë emocionesh • Ndahet më lehtësisht nga prindërit 	<ul style="list-style-type: none"> • Dëshiron të kënaqë shokët • Dëshiron të jetë si shokët • I ndjek rregullat më me lehtësi • Është i ndërgjegjshëm për gjininë • Është i aftë të dallojë fantazinë nga realiteti



ZHVILLIMI I KOMUNIKIMIT VERBAL DHE GJUHËS SË XHESTEVE

(Aftësitë Gjuhësore)

Brenda muajit të 4	Brenda moshës 1-vjeçare-12 muajsh	Brenda moshës 2-vjeçare	Brenda moshës 3-vjeçare	Brenda moshës 5-vjeçare
<ul style="list-style-type: none"> • U përgjigjet zërave të njohur • Ndjek me sy fytyrat • Imiton shprehjet e fytyrës • I komunikon nevojat kryesisht duke qarë • Lëshon tinguj kënaqësie (gugatje, etj.) 	<ul style="list-style-type: none"> • Përgjigjet kur dëgjon emrin e tij • Fillon tu përgjigjet "Jo"-ve • Përdor zërin për të shprehur gëzim apo pakënaqësi • I kushton gjithnjë e më shumë vëmendje asaj që thuhet dhe përpqet të imitojë fjalë. • Belbëzimi nis t'i ngjajë më shumë të folurës. • Mund t'i përgjigjet kërkesave të thjeshta gojore • Përdor gjestet, kontaktin me sy dhe tingujt gojorë për të komunikuar 	<ul style="list-style-type: none"> • Tregon me gisht objektin/foton kur i përmendet emri. • Thotë mjaft fjalë të shkëputura • Përdor fjali me 2-3 fjalë (më shumë qumësht) dhe pyetje (Ku qeni? Iku da da?) • Thotë "të lutem" dhe "faleminderit" kur nxitet nga dikush • Përpqet të këndojë • Merr pjesë në bashkëbisedime ku flitet me radhë 	<ul style="list-style-type: none"> • Ndjek një urdhër të ndarë në 2-3 pjesë • Njih dhe emëron thujtje të gjithë objektet e zakonshme. • Përdor fjali me 4-5 fjalë • Mund të thotë emrin dhe moshën • Përdor përemrat – unë, ti, ata, etj. 	<ul style="list-style-type: none"> • Kujton pjesë të një historie • Thotë fjali me më shumë se 5 fjalë • Përdor kohën e ardhme në bashkëbisedim • Tregon histori më të gjata • Thotë emrin, adresën, punën e mamit dhe të babit etj.



KUJDES! SHIHNI NGA AFËR SI ZHVILLOHET FËMIJA....

Vëzhgoni vazhdimisht zhvillimin e fëmijës për vonesa të mundshme zhvillimore. Mund të shqetësoheni kur:

Brenda muajit të 4	Brenda moshës 1-vjeçare-12 muajsh	Brenda moshës 2-vjeçare	Brenda moshës 3-vjeçare	Brenda moshës 5-vjeçare
...fëmija është 4 muajsh dhe duket se nuk reagon ndaj zhurmave të larta / nuk belbëzon / nuk sulet drejt lodrave.	...fëmija është 1 vjeç dhe nuk shkon në kërkim të objekteve kur ia fshehin ato / nuk përpiqet të zvarritet këmbadoras.	...fëmija është 2 vjeç dhe nuk ecën / nuk flet të paktën 15 fjalë / nuk njih objektet më të zakonshme.	...fëmija është 3 vjeç dhe rrëzohet shpesh / nuk kopjon dot diçka me shkarravina, nuk ka interes për fëmijët e tjerë / nuk komunikon dot me fjalë të shkurtra.	...fëmija është 5 vjeç dhe nuk arrin të kuptojë komandat me dy pjesë / është i hutuar dhe e ka të pamundur të përqendrohet në ndonjë veprimtari për më shumë se 5 min.

Në rast se vëzhgoni shenja të tilla, kontaktoni me mjekun peditar dhe psikologun për tu siguruar se shqetësimi juaj është i drejtë. Ju si punonjës i çerdhes/kopshtit, së bashku me të dy këta specialistë mund të gjeni mënyrën e përshtatshme për të mbështetur zhvillimin e fëmijës, duke zhvilluar potencialin e tij të plotë.





Save the Children

Programi për Shqipërinë

Save the Children po punon për të mbështetur zhvillimin e fëmijëve në moshat e hershme (prej 0 deri në 6 vjeç) përmes një projekti që zbatohet në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore në të gjithë vendin.

Ky projekt synon kryesisht përmirësimin e njohurive të kujdestarëve të çerdheve, mësuesve të kopshteve, mjekëve pediatër dhe prindërve, për zhvillimin tërësor të fëmijës. Projekti ka synuar ti paisë ata me mënyra praktike për të nxitur zhvillimin e fëmijëve dhe për të dalluar vonesa të mundshme zhvillimi në moshën e hershme. Një grup pediatresh zhvillimi ju kanë qëndruar afër atyre në procesin e identifikimit dhe trajtimit të vonesave zhvillimore tek fëmijët që ndjekin çerdhet dhe kopshtet e projektit.

Për tu siguruar se shërbimi që u jepet fëmijëve në kopshtet e projektit është cilësor dhe i bazuar në njohuritë që merren në trainimet e organizuara nga Save the Children, është bashkëpunuar me Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore. Personeli i këtyre institucioneve siguron monitorimin dhe këshillimin e mësuesve gjatë punës me fëmijët.

Një pjesë e rëndësishme e projektit, janë botimet e ndryshme të cilat shpërndajnë si tek grupet e synuara, edhe tek publiku më i gjerë, informacion për zhvillimin e fëmijëve në moshat e hershme. Ky libërth vjen në dorën tuaj si një prej shumë botimeve të këtij projekti, të cilat përmbledhin, libra, fletëpalosje, postera etj.

Save the Children ka nisur të punojë në fushën e Zhvillimit të Fëmijërisë Hershme që prej vitit 2000 dhe do të vazhdojë edhe në vitet në vijim.

Nëse doni më shumë informacion për këtë projekt, ju lutem na kontaktoni në:

Tel: +355 4 261840 / 261929 / 266227

Fax: 00355 4 263 428.

E-mail: savealbania@scalbania.org

Web: www.scalbania.org

